

AKTI I THEMELIMIT

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“GB-a konstruktion” sh.p.k.

Themeluesi që firmos më poshtë :

Gerti ÇALLIKU, i biri i Petritit, i datëlindjes 03.09.1976, banues në TIRANË.

Që në vijim do të quhet **Ortak.i vetem.**

Sot më datë 11.11.2003, bazuar në vullnetin e tij të lirë dhe në përputhje me ligjin Nr. 7638 datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare”, ligjin 7667, datë 28.01.1993 “Për regjistrimin tregtar”, vendosi të themelojë Shoqërinë tregtare me përgjithësi të kufizuar, “**GB-a konstruktion**” në bazë të kushteve që vijojnë:

Kreu I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, RREGJIMI JURUDIK

Neni 1.


Objekti i Shoqërisë :

Shoqëria ka këtë objekt veprimtarie :

1.1.

- Eksport.-import, tregti me shumicë e pakicë të mallrave industriale, ushqimore, makineri e pjesë këmbimi të të gjitha llojeve, paj sje elektrike, hidraulike, hidrosanitare, lëndë të para, materiale të ndërtimit, inerte, produkte të gatshme e gjysëm të gatshme, konfeksione, duralumën, pajisje elektroshtëpiake, etj.
- Investime në fushën e ndërtimit, punime dheu, sistemime, tarracime, ndërtime civile, ekonomike, tregtare, bujqësore, kulturore, sportive, të veprave të kultit, të objekteve

Gerti Çalliku
11/11/2003



sociale, hoteleve, fshatrave turistike, etj. Ndërtime dhe projektme rrugësh, tunelesh, urash, vepra ujore, hekurudhore, kanalizime, diga, vepra arti, impiante hidrike, rregullimi e sistemimi i tyre, asfaltim e punime të të gjitha kategorive që përfshihen në sistemin e ndërtimeve, ndërtime dhe projektme objektesh për banim dhe shtesa e rikonstruksione në godina egzistuese, mirëmbajtje fasadash, punime restaurimi, punime karpenterie, metalike, punime të mirëmbajtjes, sinjalizimit dhe vijëzimit në rrugë.

1.2.

- Shoqëria kryen çdo lloj veprimtarie të dobishme për arritjen e objektivit të saj, duke përfshirë edhe veprime për shit-blerje sendesh të luajshme dhe të paluajshme, pjesëmarrje me kuota dhe aksione në shoqëri dhe ndërmarje të tjera.

Neni 2.

Emërtimi dhe selia e Shoqërisë.

2.1. Ortaku i vetëm vendosi që shoqërinë ta emërtojë :

“GB-a konstruksion” sh.p.k.

2.2. Selia e Shoqërisë ndodhet në TIRANË.

“EDAL CENTER”Rruga **“PUNTORET E RILINDJES”**, perballe Parlamentit

2.3. Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

2.4. Vendndodhja e Ortakut të vetëm në marrëdhënie me Shoqërinë do të jetë ajo që rezulton e shënuar në librin e Shoqërisë.

Neni 3.

Rregjimi juridik.

3.1. Shoqëria e rregullon veprimtarinë e saj në përputhje me statutin e saj dhe me aktet ligjore e nenligjore të Republikës së Shqipërisë.

3.2. Me vendimin e Ortakut të vetëm mund të ndryshojë rregjimi juridik i Shoqërisë, në qoftë se në të ardhmen krijohen premisa më të favorshme për funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Në këtë rast Ortaku i vetëm do të përshtasi Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqërisë, si dhe të bëjë regjistrimin e tyre në regjistrin tregtar nga organet kompetente shqiptare.

3.3. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar nga organet kompetente dhe në përputhje me ligjin.

3.4. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

11003

3.5. Te gjitha mosmarrveshjet me organet shtetore, me personat juridike e fizike vendas e te huaj zgjidhen me mirkuptim, ne te kundert nga Gjykata e Shkalles se Pare Tirane.

Kreu II

KAPITALI I SHOQERISE

4.1. Kapitali baze i themelimit te shoqerise perbehet nga kontributi fillestar i ortakut te vetem. Kapitali i deklaruar eshte 100.000 leke, sipas vertetimit te bashkengjkitur.

Neni 4.

Të drejtat Shoqerise dhe të Ortakut te vetem.

5.1. Ortaku i betem ka te drejte qe me nxjerrjen e bilanceve periodike ose vjetore te perfitoje perqindjet e realizuara nga veprimtaria e shoqerise e parashikuar ne statut.

5.2. Shoqeria mban pergjegjesi per te gjitha detyrimet fiskale, sigurimet shoqerorwe ndaj te treteve, etj.

5.3. Per shkeljet e mundshme, ortaku i vetem mund te marre masa disiplinore ndaj kujtdo, pavaresisht nese shkelja eshte bere me dashje apo nga pakujdesia.

Neni 5.

KOHEZGJATJA

6.1. Aktiviteti i shoqerise do te zhvillohet me nje afat mbi 10 vjet.

Kreu III

DISPOZITA TE FUNDIT

Te gjitha mosmarrveshjet me organet shtetore, me personat juridike e fizike vendas e te huaj zgjidhen me mirkuptim, ne te kundert nga Gjykata e Shkalles se pare Tirane.

U themelua sot me daten 11.11.2003.

THEMELUESI
Gerti ÇALLIKU

GERTI ÇALLIKU
2003

STATUTI

I



SHOQERISE ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUAR

“GB-a konstruksion” sh.p.k.

KREU I

DISPOPZITA TE PËRGJITHSHME

NENI 1

Shoqeria me përgjegjësi të kufizuar “GB-a konstruksion” shpk, krijohet në bazë të Aktit të Themelimit, datë 11.11.2003. Shoqeria është person juridik i pavarur, me të drejta e detyrime, për të cilat përgjigjet brenda kufijve të përcaktuar me ligj

NENI 2

Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj në bazë të ekonomisë së tregut të lirë. Baza ligjore është ligji Nr. 7512, datë 10.08.1991 dhe ligjin 7638 datë 9.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare”.

NENI 3

Themeluesi i Shoqërisë ka derdhur kapitalin e tij me qëllim që të sigurojë fitimin e njohur me ligj dhe të përfitojë të ardhurat që do të rrjedhin prej saj.

NENI 4

Ortaku i vetëm përballon humbjet vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

NENI 5

Shoqeria “GB –a konstruksion” shpk, fiton zotesinë për të vepruar me regjistrimin në Gjykatën e Shkalles së Parë Tiranë si dhe me pajisjen me licensën përkatëse, në juridiksionin përkatës.

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, RREGJIMI JURUDIK

Neni 6.

Objekti i Shoqërisë :

Shoqëria ka këtë objekt veprimtarie :

1.1.

- Eksport-import, tregti me shumicë e pakicë të mallrave industriale, ushqimore, makineri e pjesë këmbimi të të gjitha llojeve, pajisje elektrike, hidraulike, hidrosanitare, lëndë të para, materiale të ndërtimit, inerte, produkte të gatshme e gjysëm të gatshme, konfeksione, duralumin, pajisje elektroshtëpiake, etj.
- Investime në fushën e ndërtimit, punime dheu, sistemime, tarracime, ndërtime civile, ekonomike, tregtare, bujqësore, kulturore, sportive, të veprave të kultit, të objekteve sociale, hoteleve, fshatrave turistike, etj. Ndërtime dhe projektme rrugësh, tunclesh, urash, vepra ujorë, hekurudhore, kanalizime, diga, vepra arti, impiante hidrike, rregulimi e sistemimi i tyre, asfaltim e punime të të gjitha kategorive që përfshihen në sistemin e ndërtimeve, ndërtime dhe projektme objektsh për banim dhe shtësi e rikonstruksione në godina egzistuese, mirëmbajtje fasadash, punime restaurimi, punime karpenterie, metalike, punime të mirëmbajtjes, sinjalizimit dhe vijëzimit në rrugë.

1.2.

- Shoqëria kryen cdo lloj veprimtarie të dobishme për arritjen e objektit të saj, duke përfshirë edhe veprime për shit-blerje sendesh të luajtshme dhe të paluajtshme, pjesëmarrje me kuota dhe aksione në shoqëri dhe ndërrmarje të tjera.

Neni 7.

Emertimi dhe selia e Shoqërisë.

- 2.1. Ortaku i vetem vendosi që shoqërinë ta emërtojë :
“GB-A konstruksion”
- 2.2. Selia e Shoqërisë ndodhet në **TIRANE**, “**EDAL CENTER**” Rruga “**Puntoret e Rilindjes**”, perballë Parlamentit
- 2.3. Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.
- 2.4. Vendndodhja e Ortakut të vetem në marrdhënje me Shoqërinë do të jetë ajo që rezulton e shënuar në librin e Shoqërisë.

A003



Neni 8. Rregjimi juridik.

- 3.1 Shoqëria është shoqëri me përgjithësi të kufizuar. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit, si dhe legjislacionit në fuqi në Shqipëri.
- 3.2. Me vendimin e tij Ortaku i vetëm mund të ndryshojnë rregjimin juridik të Shoqërisë, në qoftë se në të ardhmen krijohen premisa më të favorshme për funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Në këtë rast Ortaku i vetëm do të përshtasi Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqërisë, si dhe të bëjë regjistrimin e tyre në regjistrin tregtar nga organet kompetente shqiptare.
- 3.3. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar nga organet kompetente dhe në përputhje me ligjin.
- 3.4. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 9.

Të drejtat e Shoqërisë dhe të Ortakut të vetëm.

- 4.1 Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshkruajë kontrata në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.
- 4.2 Shoqëria ka të drejtë të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.
- 4.3 Shoqëria ka të drejtë të marrë pjesë si ortak në shoqëri ose ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 4.4 Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm dhe eskuzivisht me kapitalin e saj shoqëror të derdhur dhe me të mirat e pasurisë së saj.

[Handwritten signature]
1003

4.5 Shoqeria "GB – a konstruksion", do te kete administrator ortakun e vetem Gerti CALLIKU.

4.6 Administratori ka per detyre te drejtoje veprimtarine e shoqerise sipas kompetencave qe i jep ligji.

4.7 Ne marredhenie me te tretet, administratori angazhon shoqerine nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj dhe kompetencat e tij. Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administratorit.

4.8 Administrator mund te kryeje te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise.

4.9 Administrator eshte pergjegjes ndaj shoqerise per shkelje te ligjeve, te statutit apo faje gjate administrimit te shoqerise.

4.10 Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne maredhenie me organet shtetere, me personat juridik e fizike vendas e te huaj ne emer te shoqerise.

4.11 Ortaku i vetem eshte organi me i larte i shoqerise dhe merr vendime te cilat jane te detyrueshme per shoqerine dhe te tretet. Ka keto kompetenca :

- Te miratoje raportin e administrimit, inventarewt dhe llogarite vjetore te hartuara nga eksperti kontabel.
- Vendos ndryshimin e statutit te shoqerise.
- Vendos ndarjen e fitimit dhe mbulimin e humbjeve.
- Rregullon maredhenit e punesimit dhe te shperblimit si dhe kushtet e punes.
- Vendos prishjen e shoqerise ose shnderrimin e saj ne nje forme tjeter.
- Cakton organikat e shoqerise.
- Pe cakton detyrimet ndaj organeve shtetere dhe personave juridik e fizik vendas dhe te huaj.
- Pe cakton masat ndeshkimore ndaj personave qe kane thyer statutin e shoqerise apo ligjet e shtetit.

Neni 10.

Kohëzgjatja.

Kohezgjatja e shoqerise eshte mbi 10 vjet.

Kreu III

KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

1003

Neni 11.

5.1 Kapitali themeltar është 100.000 Lekë (njëqind mijë).

5.2 Kuotat janë nominative. Kapitali shoqëror mund të ndahet në kuota me shuma jo më të vogla se 1000 Lekë (njëmijë).

5.3 Kuotat e Shoqërisë janë të ndara si vijon :

Gerti ÇALLIKU

100.000 lekë përkatësisht 100%.

5.4 Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar duhet të nënshkruhen në tërësinë e tyre nga Ortaku i vetem dhe të shlyhet krejtësisht, si për rastet kur përfaqësojnë kontribute në para, ashtu edhe në natyrë. Ato nuk mund të përfaqësojnë kontribute në shërbime.

Neni 12

MARREDHENIT FINANCIARE

1. Shoqëria mund të lidhë kontrata me sektoret shtetërore ose me persona juridik vendas e të huaj. Në veprimet kontraktore shoqëria përfaqësohet nga ortaku i vetem. Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontrata janë të detyrueshme për shoqërinë.
2. Shoqëria përgjigjet për kontributin fiskal, afatin e derdhjes së tij, detyrimet ndaj shtetit, sigurimet shoqërore, etj.
3. Shoqëria ka të drejtë të sigurojë kreci nga Banka e Shtetit Shqiptar, banka të huaja dhe banka private vendase si dhe të çele ilogari përkatëse pranë tyre.
4. Për pasqyrimin e aktivitetit, administratori është i detyruar të mbajë dokumentacionin e rregullt financiar dhe regjistrat përkatës si dhe të bëjë deklarinë e të ardhurave në organin tatimor në fund të vitit.

MARREDHENIT E PUNESIMIT

1. Marrëdhëni e punësimit rregullohen sipas kontratës së punës që lidhet midis palëve. Marrja në punë bëhet me regjistrimin e punonjesve në librin e punës së shoqërisë, duke njoftuar organet e punës së juridiksionit përkatës.
2. Në kontratën e punës përcaktohen kushtet, afatet, shpërblimet dhe pushimet.

7/1003

5. Ndryshimi i vendit te punes ose largimi nga shoqeria, behet ne baze te nje akti te keshtuar me shkrim te vendosur nga ortaku i vetem. Punonjesi qe largohet duhet te beje dorëzimin e detyres ne baze te nje akti me shkrim pasi te kete likuiduar detyrimet materiale e monetare.

KREU IV

NENI 13

BILANCI DHE TE ARDHURAT

1. Shperblimi per personat e punesuar caktohet sipas kontrates se punes. Ndryshimi ne page vendoset nga ortaku i vetem.
2. Te ardhurat neto percaktohen pas shlyerjes se detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqerore, etj. Keto kalojne ne dispozicion te ortakut te vetem.
3. Te ardhurat neto percaktohen pas shlyerjes se detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqerore, etj. Keto kalojne ne dispozicion te ortakut te vetem.
4. Aktiviteti i shoqerise mbyllet ne muajin dhjetor te çdo viti. Fitimi qe do te merret perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilit i jane zbritur ose shtuar humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme.
5. Kur pushon aktiviteti i shoqerise, kapitali i mbetur, pasi shlyen te gjitha detyrimet, kalon ne pronesi te ortakut te vetem.

SHPERNDARJA E SHOQERISE

1. Shoqeria perballon humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kontributeve.
2. Ne rast se kaptalet e shoqerise rezultojne me te vogla se gjysma e kapitalit baze, ortaku i vetem vendos mbi mundesine e prishjes se parakohshme te shoqerise dhe mund te kerkoje ne gjykate prishjen e saj.
3. Percakton shlyerjen e detyrimeve ndaj te treteve, cakton likuidatorin dhe menyren e likuidimit te shoqerise. Ne te kundert kjo procedure do te ndiqet nga gjykata.

DISPOZITAT E FUNDIT

1. Mosmarreveshjet e shoqerise me persona juridik, fizik vendas e te huaj, zgjidhen nga Gjykata e Shkalles se pare Tirane.
2. Persa nuk eshte shprehur ne kete Statut, i referohet ligjit "Per Shoqerite Tregtare" dhe çdo ligji tjeter qe rregullon veprimtarine e shoqerive tregtare ne Republiken e Shqiperise.
3. Statuti u perpilua ne 4 (kater) kopje dhe u nenshkrua nga ortaku i vetem, sot me daten 11.11.2003.

THEMELUESI

LEARTI CALIQU

11/11/2003